



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9925 prot.

Vlorë, më 2006 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2025

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË ZNJ.MEGI SULAJ DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR
NGA ANA E BASHKISË VLORE.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj.Megi Sulaj, e ndodhur në lagjen “Pavarësia”, Rajoni Nr3, Bashkia Vlorë, në datën 11.03.2025, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 33.676 (tridhjet e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjet e gjashtë) lekë për punime ndërtimi (67.352x50%).

B. 212.276(dyqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 3325 prot.

Vlorë, më 20.06 2025

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E ZNJ.MEGI SULAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë datë 12.03.2025 ka paraqitur kërkesën znj.Megi Sulaj me nr.4008prot. për shkakë të djegies së banesës në datë 11.03.2025 e ndodhur në lagjen “Pavarësia”, Rajoni Nr.3, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.26 datë 24.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 13.03.2025, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.4008/1 prot, datë 09.04.2025“Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të znj.Megi Sulaj në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.4008/2 prot, datë 28.05.2025 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të znj.Megi Sulaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e znj.Megi Sulaj është 245.952 (dyqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjet e dy) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e znj.Megi Sulaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Dorian Demiri

